



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

1

A nr.201 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nihat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) në Graçanicë për shkak të dëmtimit të billboardit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 17.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS).

Arsyetim

Me datën 08.10.2013, subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datat 07.10.2013 dhe 08.10.2013 në mes të natës në Graçanicë ku është dëmtuar një billboard i partisë Samostalna Liberalna Stranka, dhe se janë ngjyrosur të dy anët e billboardit ashtu që billboardi është dëmtuar me ngjyrë nga të dy anët dhe në pjesën qendrore.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ia ka bashkangjitur ankesës dy fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, ka konstatuar se pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse pasi që pala ankuese në ankesë nuk e ka cekur kryesin e shkeljes së supozuar. Andaj PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1

dhe në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 201 /2013 më datën 17.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.,*